



Fundi i një frustrimi, fillimi i një ere të re

Preç Zogaj

Sot do të mbahet në Bruksel takimi zyrtar që shënon hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Më në fund, pasi qeveria jonë kishte festuar një herë vite më parë hapjen e tyre propagandistike, kemi një zhvillim real që nuk ka gjasa të futet sërish në limbo.

Kalendari i integritit tonë në BE ka fluturuar me kohë nga afatet e ëndrrës, pritjes dhe mund të themi edhe të shpërblimit të merituar për popullin më proeuropian në Ballkan. Nesër, ironikisht, do të marrim atë që Serbia dhe Mali i Zi e kanë marrë prej vitesh. Megjithatë, hapja e negociatave është një ngjarje pozitive me vlerë të madhe për ne.

Ëndrra vazhdon. Më mirë vonë se kurrë. Më mirë brenda se jashtë. Më mirë nën regjimin e rreptë të normave dhe arritjeve standarde europiane se sa nën të ashtuquajturin “sovrinizëm” të reklamuar nga një skotë bajraktarësh politike që kanë sunduar e sundojnë duke shkatërruar zgjedhjet e lira, sundimin e ligjit, qarkullimin e elitave, trasparencën dhe llogaridhënien. Me fjalë të tjera themelet e rendit demokratik euroamerikan.

Ne nuk kemi dhe as duhet ta çojmë nëpër mend të kemi një busull tjetër përveç asaj perëndimore. Historia flet: sa herë që elitat politike të Tiranës i kanë kthyer kurrizin apo mbyllur derën perëndimit për interesat e pushtetit të tyre, vendi ka rënë në fatkeqësi.

Hapja e negociatave ishte shndërruar në frustrim për shumicën europianiste në Shqipëri. Si një provim të cilin dukej sikur nuk do ta merrnin kurrë.

Dy-tre herë na ngelën Franca, Holanda, Danimarka. Njëherë tjetër na e shtynë provimin kushtet e Gjermanisë që më parë kishte qenë në pararojë të zemërgjerësisë ndaj nesh. Me këtë rast u bëmë ne shkak që të penalizohej Maqedonia e Veriut. Pastaj doli në skenë vetoja Bullgare për Maqedoninë e Veriut prej së cilës u penalizuam ne dy herë rresht.

Si akt, vendimi për hapjen e negociatave miksion vlerësimin për përmbushjen e kritereve me momentin politik të BE-së dhe vendeve anëtare në lidhje me politikat e zgjerimit. Është shumë vështirë të kuptohet ku mbaron aspekti teknik dhe ku fillon momenti politik. Arsye për të thënë “jo” gjen sa herë të duash po t’i kërkosh. Vetë kriteret janë si llastik në këtë fazë. Duhet t’i kesh përmbushur në ekstrem që t’u mbyllësh gojën të gjithëve e të mundësh edhe pengesat politike.

Shqipëria i ka armatosur rregullisht mospranuesit e saj. Sidomos me nivelin e lartë të korrupsionit dhe me plot ngjarje të tjera që kanë vizatuar një vend me probleme të mëdha të sundimit të ligjit.

Sidoqoftë, duke e ditur se hapja e negociatave nuk është hyrje në BE, por thjesht kualifikim për të vijuar provimet e hyrjes si dhe duke parë pingpongun e refuzimeve, herë për një arsye e herë për një tjetër, njerëzit në Shqipëri po bëjnë pyetje të rënda, dëshpëruese: Mos nuk na duan fare? Mos po luajnë me ne?

Këto pyetje ranë në fund të javës së shkuar. Së paku për hapjen e negociatave. Falë impenjimit me një propozim konkret të Presidentit të Francës, Emanuel Macron, që u votua nga parlamentet e Sofies dhe Shkupit, vetoja bullgare për Maqedoninë e Veriut u hoq.

Presidenti Macron, parlamenti bullgar dhe ai maqedonas, ku deputetët e partive shqiptare kishin një rol vendimtar, shkruan emrin e tyre në zhbllokimin e ngërçit të madhe dhe meritojnë mirënjohjen e europianistëve kudo ku janë.

Por duhet ta themi: Koshienca e re e bashkimit të Perëndimit demokratik në mbështetje të Ukrainës përballë agresionit të paprovokuar e të pajustificuar kundër saj nga ana e Ruisë ka shërbyer për të përshpejtuar proceset integruese në BE të vendeve kandidate si Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, apo vendeve aspirante, si Ukraina dhe Moldavia.

Edhe njëherë, përmes zhbllokimit të një ngjarjeje konkrete të favorshme për ne, siç është hapja e negociatave, kuptojmë e duhet të kuptojmë më mirë se nuk jemi një ishull i shkëputur nga bota, siç predikojnë strucët dinakë të politikës së vjetër. Falë hapjes jemi në ndikimin e drejtpërdrejtë të zhvillimeve brenda familjes europiane dhe euroatlantike për çdo gjë të rëndësishme që ka lidhje me sigurinë, ekonominë, drejtësinë, kulturën dhe jetën tonë.

Ashtu si me SHBA-në, marrëdhëniet me BE nuk janë e nuk duhet të shihen në optikën partiake apo të pozicionit të partive në periudhën e dhënë. Ka plot tema, çështje dhe qasje për t'u diferencuar e konfrontuar politikisht me njëra tjetrën brenda vendit.

Opozitës, siç e kemi thënë shpeshherë, i shkon të sillet e të shtyjë si qeveria-dhe kur është nevoja edhe më fort se qeveria-për integrimin e vendit në BE. Historia ka treguar se asnjë qeveri nuk ka përfutur elektoralisht nga sukseset në procesin e integritimit. Ndoshta sepse sukseset kanë ardhur me vonesë. Ndoshta sepse qytetarët i perceptojnë këto arritje si produkte të hapjes dhe jo aq të qeverive. Kur PD nuk përfitoi elektoralisht nga heqja e vizave që ishte një arritje konkrete e prekshme për çdo qytetar, merret me mend se çfarë mund të kapitalizojë Rama nga hapja e vonuar e negociatave.

Hapja e negociatave ngre siparin e fragmentit me të gjatë të rrugës për t'u anëtarësuar me titull të plotë në BE. Mirë është të nxitojmë sa të mundemi. Sidoqoftë, natyra e detyrave për t'u përmbushur në këtë fazë është e tillë që vendi dhe demokracia përfitojnë thjesht duke përshtatur e zbatuar hap pas hapi, njërin pas tjetrit, tridhjetë e pesë kapitujt voluminozë të europianizimit. Europianistët e çdo kahu politik që janë shumicë dërmuese kanë vërtetë arsye të kenë shpresë se përmes "provimit" të negociatave do të kemi më shumë demokraci, zgjedhje me të mira, sundim me të fortë të ligjit.

Ky shkrim është pjesë e serise se shkrimeve rreth integritimit europian, të Institutit Shqiptar të Medias, në kuadrin e Programit të Promovimit të Tranzicionit të Republikës Çeke.